

Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (15)

Reagimet ndaj Milosheviqit

Kosova i përgjigjej Milosheviqit me rezistencë paqësore, Bosnja me kosmopolizëm sekularist, ndërsa kroatët nacionalizmit iu përgjigjën me nacionalizëm

Patriarku Pavle më 14 qershor të vitit 1992 po e shfrytëzonte meshën e paqes për të kërkuar dorëheqje të Slobodan Milosheviqit nga posti. Në një fjalim 10-minutësh të tij, Pavle e kritikoi Milosheviqin se ka nxitur urrjetje dhe ka nxitur konflikte “që do ta turpëronin edhe dreqin”. Reagimi zyrtar ishte: Kisha nuk ka të drejtë të përziehet në politikë.

Reagimet e patrikut Pavle ishin disa nga kritikrat e brendshme që i bëheshin Milosheviqit.

Kritika të jashtme kishte në fushë-beteja në Kroaci dhe në Bosnjë si dhe në rezistencën paqësore në Kosovë. Në Bosnjë bënin përpjekje që provokimeve serbe t’u përgjigjeshin me kosmopolizëm sekular, ndërsa në Kosovë lëshonin pe, për të mos u përballur me ushtrinë mirë

të armatosur të shtetit serb. Mirëpo, kroatët iu kundërpërgjigjën nacionalizmit me nacionalizëm. Kroatët thonë se këtë e kanë bërë në vetëmbrojtje, ndonëse siç është parë më vonë në Bosnjë-Hercegovinë, ky nacionalizëm nuk ka qenë thjesht mbrojtës. Qysh më 1981 në fshatin Megjugorje në Bosnjë të banuar me kroatë disa persona kishin qenë dëshmitarë se si figura e Shën Mërisë kishte derdhur lot. Në fillim të viteve nëntëdhjetë Tugjmani dhe shumë kroatë të tjerë, më se dhjetë vjet më pas, nisën ta interpretonin këtë dukuri si një shenjë të ringjalljes kroate. David Bruce MacDonld thotë se në Megjugorje më 1981 nuk kishte pasur asnjë fenomen të natyrës: aty ishte vetëm fenomeni politik i nacionalizmit kroat. Kroatët i nisën temat e persekutimit dhe të viktimizimit. Sipas shënimeve kroate, ideja e Serbisë së Madhe brenda shekullit 20 kishte marrë jetët e 600.000 kroatëve, të 400.000

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Peroviq. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (1)

I biri i berberit

Gabriele dhe Teresina Capone kishin ardhur në Amerikë më 1894, me shpresën që të bënë një jetë të qetë dhe të ndershme. Gabriele do të punonte berber e Teresina do të kujdesej për fëmijët dhe punët e shtëpisë. Kur më 1899, u lindi djali i katërt, Alphonso, ata ende ishin duke vazhduar me të njëjtën shpresë

Është shkruar e stërshkruar deri më tash për Al Caponen nëpër gazeta e revista, libra e skenarë filmash, por, kryesisht, ato që janë shkruar nuk janë të vërteta. Rrëfimi për Caponen, njeriun më të fuqishëm dhe më të njohur të nëntokës, është tjetër nga ato të filmave. Një nga të pavërtetat është kjo që thuhet se Al Capone ka lindur në Itali. Mirëpo, në këtë fejton të përpiluar në bazë të

shkrimeve të Marilyn Bardsley është shkruar një nga historitë më të sakta për jetën dhe veprën e tij. Shumë emigrantë italianë, si edhe emigrantët e tjerë të fundit të shekullit të 19-të dhe të fillimit të shekullit të 20-të në Itali, ishin fshatarë të varfër që vinin të mah-nitur duke e parë portin e qytetit të madh amerikan. Shumica e tyre nuk dinin të flisnin anglisht,

të shkruanin e të lexonin, as nuk kishin ndonjë zanat. Familja Capone ishte ndryshe. Gabriele Capone ka qenë vetëm njëri nga 43.000 italianët që më 1894 ka hapur gojën në shenjë mahnitjeje kur e ka parë për herë të parë Amerikën. Ai kishte zanat. Ishte berber. Dinte të shkruante e të lexonte. Ishte i lindur në fshatin Castellmare di Stabia afër Napolit.

Gabriele, atëherë 30-vjeçar, me vete në Amerikë e kishte marrë gruan e tij shtatzënë, Teresinën, dhe dy djemtë Vincenzon dhe Raffaelon që ishte ende foshnjë. Familja katëranëtarëshe Capone u vendos me qira në një banesë në Brooklyn pa ujë të nxehtë dhe pa nevojtoje. Ishte një lagje afër bregut të oqeanit, me plot vese të marinarëve që endeshin pa ndër-prerë.

Së shpejti Teresina Capone e lindi edhe djalin e saj të tretë, Salvatore. Familja kishte gati pesë vjet në Amerikë kur u shtua edhe për birin e katërt. Kishte lindur më 1899. E quajtën Alphonso. Shumë vjet më vonë ky farë Alphonsoja, ose Al, siç do ta quanin miqtë, do të bëhej gangsteri më i zulmëkeq që ka ekzistuar në fytyrë të dheut. Cilët ishin ata prindër që e kishin sjellë në botë këtë njeri kaq të tmerrshëm? A i kanë rrahur fëmijët e tyre? A kanë qenë gjenetikisht violentë? A janë shoqëruar me vrasës dhe me hajna?

Jo. Familja Capone ka qenë familje e qetë dhe e ndershme. Laurence Bergreen, autore e biografisë së Capones, ka shkruar se nëna Teresina Capono ka qenë



Kroatët nacionalizmit iu përgjigjën me nacionalizëm

myslimanëve dhe të 100.000 shqiptarëve. Derisa serbët nisën të bashkëndjenin me çetnikët, tani kroatët nisën të bashkëndjenin me ustashët. Nacionalizmi kroat ishte i ngjashëm me nacionalizmin serb për shumë gjëra, përfshirë edhe qëllimin kryesor - zgjerimin e kufijve.

Në këtë kuadër, Gojko Sushak që ishte zyrtar i Tugjmanit, në prill të vitit 1991, i përcjellë nga disa

rekrutë kroatë, shkoi në Borovo Selo të banuar me serbë dhe hodhi tri granata me minahedhës. Disa historianë thonë se Tugjmani ka pasur dëshirë që të vazhdonte lufta me Serbinë. Mirëpo, edhe në Kroaci kishte pacifistë që nuk pajtoheshin me regjimin e Tugjmanit.

(Në numrin e nesërm: Çka i sollën Serbisë idetë ekspansioniste?)



New Yorku i vitit 1899, kur ka lindur Al Capone

grua e shtëpisë, ndërsa babai Gabriele ka qenë njeri i pashëm që gjithnjë i ka marrë me të mirë fëmijët dhe u ka treguar rrëfime të ndryshme.

“Në familje nuk ka pasur asnjë ngjarje traumatike, asnjëri në familje nuk ka pasur personalitete sociopatike ose psikotike - nuk ishin të krisur. Ishte kjo një familje italo-amerikane që nuk kishte sjellje violente në asnjë

mënyrë”, thotë Bergreen.

Më 1906, Gabriele e mori shtetësinë e Amerikës. Pas Alit, familja u shtua edhe me 5 fëmijë të tjerë. Mbreti i nëntokës është rritur në një familje të qetë e të ndershme 9-anëtarëshe.

(Nesër: Si kaloi fëmijëria e Al Capones? A ishte nxënës i mirë? Çka ndodhi kur familja e ndërroi mëhallën?)

Gangsterë të tjerë të shquar

Salvatore Maranzano

Salvatore Maranzano i njohur me nofkën “Bosi i bosëve” ka lindur në Sicili më 1868 dhe ka vdekur më 1931 në Amerikë. Si fëmijë kishte dëshiruar të bëhej prift dhe madje kishte mbaruar edhe fakultet, por më pas kishte ndërruar mendje dhe ishte bërë mafioz. Maranzano ka qenë i fascinuar me Perandorinë Romake dhe shumë nga rregullat e asaj periudhe i ka zbatuar. Ka qenë shefi i vetëm i mafias, me fakultet. Në Amerikë kishte ardhur më 1918 me urdhërin e shefit të tij në Itali, Don Vito Cascios me urdhër që të krijojë një mafia nën sundin e Don Vitos. Pas vrasjes me ndihmën e Lucky Lucianos të një mafiozi tjetër të quajtur Masseria, Maranzano u bë gangsteri më i fuqishëm i kohës së tij. Ai i mblodhi të pesë familjet më të mëdha mafioze të Amerikës dhe veten e shpalli “bos i bosëve”. Mirëpo, disa nga mafiozët e tjerë nuk kishin qejf të kishin bos të bosëve. Maranzano dha urdhër për t’i vrarë të padëgjueshmit si Frank Genovese e Lucky Luciano. Mirëpo, dështoi. Luciano dhe Genovese e mbytën më 1931. Megjithatë, plani i tij për ta krijuar bashkimin e pesë familjeve u realizua nga Luciano dhe Genovese.



Al Capone, njeriu më i famshëm i botës së krimit